



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 22. 06. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi – kryetar, Hajredin Hyseni, Ibrahim Makolli, Ibrahim Selmani, Drita Maliqi, Luljeta Shehu dhe Shpresa Murati.

Munguan: Nerxhivane Dauti dhe Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Fatmir Xhelili, zëvendësministri i MPB - së, Valon Krasniqi – MPB, Rrahim Tërnavë – MPB, Gani Geci – deputet, Ilir Berisha – RTV 21, Gentiana Begolli – RTK, Lumnija Blakaj – Zëri, Liridon Llapashtica – KTV, Elita Vokshi – OSBE, Nexhat Shatri – ZPRK dhe Besnik Ramadanaj – KDI.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinators dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi: Fatmir Rexhepi - kryetar.

Fatmir Rexhepi konstatoi se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendi të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 15. 06. 2010,
3. Informatë e MPB - së mbi gjendjen, masat dhe veprimet kundër trafikimit me genie njerëzore në Kosovë
4. Te ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 15. 6. 2010

Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 15. 06. 2010, pa vërejtje.

3. Informatë e MPB - së mbi gjendjen, masat dhe veprimet kundër trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë

Kryetari i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe prezencën e zëvendësministrit të MPB – së. Pastaj i informoi se në këtë mbledhje është paraparë të kemi informata më të plota për gjendjen, masat dhe veprimet kundër trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë. Arsyetimin e mbajtjes së kësaj mbledhje e mbështeti në atë se rrjedhat dhe zhvillimet që kanë pasuar me informata dhe vlerësime nga institucionet e tjera, lidhur me gjendjen momentale në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Lidhur me këtë ftoi z. Fatmir Xhelili ta marrë fjalën që ta informojë Komisionin rreth zbatimit të Strategjisë Nacionale, veprimet e ndërmarra në këtë drejtim, si dhe sa qëndrojnë konstatimet e dala që kanë të bëjnë me këtë çështje.

Fatmir Xhelili, zëvendësministri i MPB – së. E informoi Komisionin për gjendjen, masat dhe veprimet kundër trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë. Ai në vazhdim ju referua edhe Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, ku Kosova renditet në vendin e dytë për veprimet kundër trafikimit me qenie njerëzore. Përmendi sukseset e kësaj ministrie, veçanërisht implementimit të strategjisë në lidhje me këtë fushë. Duke dhënë informatë statistikore për veprimet e Policisë së Kosovës për luftimin e kësaj dukurie, ai informoi se gjatë periudhës janar - prill të këtij viti, janë kontrolluar 335 lokale të dyshimta, nga të cilat 36 nga to janë mbyllur. Ndërkaq, duke iu referuar statistikave të PK - së për trafikimin e qenieve njerëzore, zëvendësministri tha se në vitin 2008 janë evidentuar 28 raste, në vitin 2009, 22 dhe në vitin 2010, 15 raste. Ndër çështje të tjera foli edhe për parametrat që merren në kategorizimin e shteteve në këto raste, ku Kosova rangohet në mesin e shteteve të zhvilluara si, Zvicra, Turqia etj., tha se raporti është real dhe i favorshëm, duke potencuar se ka edhe gjëra të pasakta me të cilat nuk pajtohet MPB - ja. Me këtë rast ai tha se Kosova nuk është burim i trafikimit me qenie njerëzore, duke shtuar se edhe numri i lypsarëve është paraqitur jo drejt. Në fund i njoftoi anëtarët e Komisionit për Strategjinë e re kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke theksuar se model i luftës kundër kësaj dukurie do të merret Anglia, Norvegjia dhe Suedia.

Ibrahim Makolli- E falënderoi zëvendësministrin për informatat e dhëna duke shtuar se trafikimi me qenie njerëzore paraqet një nga format më të rënda të krimit të organizuar, prandaj lidhur me këtë çfarë është ndërmarrë nga ana e institucioneve tona? Në vazhdim tha se raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit është shqetësues, sepse Kosovën e cilëson si burim i trafikimit, për dallim nga raportet e kaluara që konsiderohej si vend i transitit. Lidhur me këtë ishte i mendimit që të kemi shifra se sa nga këto viktima që ju i keni të evidentuara janë vendore, cilat janë grup - moshat, cilët janë faktorët në mënyrë që të shohim se cilën pjesë të shoqërisë e ka atakuar ky fenomen. Theksoi se është dashur që MPB - ja të kërkojë sqarime lidhur me këtë raport. Pyeti cili është bashkëpunimi i MPB - së me vendet e rajonit? A keni identifikuar organizatat që japin shifra lidhur me personat e trafikuar? Sa është implementuar strategjia, cilat janë sfidat apo çka po e pengon implementimin e kësaj strategjie?

Gani Geci – Tha se trafikimi me qenie njerëzore nuk është vetëm i këtyre ditëve, por është një fenomen i mëhershëm, prandaj z. Xhelili do të duhej që të ofronte informacione - statistika më të detaizuara

lidhur me trafikimin me qenie njerëzore. Në vazhdim tha se këto raporte, qoftë ai i Departamentit Amerikan të Shtetit ose të organizatave joqeveritare e dëmtojnë imazhin e Kosovës drejt integritetit në BE. Prandaj institucionet tona do të duhej të bënin më shumë në këtë drejtim.

Hajredin Hyseni - Në fjalën e tij e falënderoi zëvendësministrin për informacionet e dhëna, si dhe punën dhe aktivitetin e Qeverisë për ta luftuar këtë dukuri, e që nuk është prezentë vetëm në vendin tonë. Informacionet e dhëna na ofrojnë një qartësi më të madhe në këtë drejtim, prandaj edhe ne, si Komisioni, kemi për qëllim që me anë të formave të ndryshme ta luftojmë këtë dukuri. Pyeti se shpesh thuhet që në pjesa veriore e Mitrovicës është burim i trafikimit edhe me qenie njerëzore, prandaj lidhur me këtë sa e vështirëson realizimin e strategjisë kundër trafikimit në këtë pjesë?

Luljeta Shehu - Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve pyeti: a keni informata se cili është vendi në Kosovë me numër më të madh të lypësve dhe në cilin vend është më i theksuar prostitucioni?

Drita Maliqi - Tha se ajo çka neve na ka shtyrë që të kemi një takimi të kësaj natyre është që të njoftohemi se si është gjendja momentale, duke cekur se në shtatë rajone të Kosovës kemi strehimore dhe mori shembull Gjilanin, duke thënë se kushtet në këtë strehimore janë shumë të vështira. Prandaj lidhur me këtë a keni paraparë që në strategjinë e ardhshme ato strehimore të ndihmohen financiarisht. Pyeti se cilat do të jenë objektivat parësore që to t'i përfshijë ajo strategji në zbatimin e këtyre dukurive?

Ibrahim Selmanaj - Duke u ndërlidhur me parafolësit tha se kemi një numër të dokumenteve dhe strategjive dhe lidhur me këtë sugjerimi i tij ishte të shtohet efektiviteti në terren, që nënkupton të ketë një bashkëpunim me Pushtetin Lokal dhe stacionet policore, sepse kjo dukuri është në rritje. Ceku se ky fenomen nuk është vetëm në Prishtinë, por edhe në qendrat e tjera. Prandaj duhet t'i kushtohet kujdes, sidomos puna në terren në bashkëpunim me qendrat për punës sociale dhe kryetarët e komunave, por edhe programet shkollore, sidomos me shkolat e mesme.

Ibrahim Makolli - Tha se trafikimi me qenie njerëzore bëhet në mënyrë të sofistikuar, që nën mbulesën e kameriereve në lokale të caktuara ushtrojnë prostitucion. Pyeti se a mbahen nën mbikëqyrjen e policisë lokalet e dyshuara? Pse Policia e Kosovës nuk zbaton legjislacionin në fuqi që të miturve nën moshën 18 vjeçare t'ua ndalojë frekuentimin në lokalet e natës?

Pyetjeve të anëtarëve ju përgjigj z. Fatmir Xhelili, zëvendësministri i MPB - së, duke ofruar sqarime shtesë rreth pyetjeve dhe çështjeve të ngritura.

4. Te ndryshme.

Kryetari paraqiti për shqyrtim Projektplanin e punës së Komisionit për gjashtë mujorin e dytë për vitin 2010. Ai kërkoi nga anëtarët që nëse kanë propozime shtesë për t'i inkorporuar mund t'i paraqesin dhe në një mbledhje të radhës t'i shqyrtojmë para se të miratohet.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 20.

Kryetari i Komisionit

Fatmir Rexhepi